



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2018

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014,**  
**“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN**  
**E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.

7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 10 për qind.”.

**Neni 2**

Në nenin 51 “Përfashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, pas shkronjës “m” shtohet shkronja “n”, me këtë përmbajtje:

“n) Furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### **Neni 3**

Në nenin 53 “Përjashtime për disa veprimtari të tjera”, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “j” fjalët “... dhe nga media elektronike ...” hiqen.
2. Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“l) Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u riekportuar, për personat e tatueshem të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit.”.

### **Neni 4**

Në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 41 shfuqizohet.
2. Pas pikës 41 shtohet pika 42, me këtë përmbajtje:

“42. Importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### **Neni 5**

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**